

# DREJTËSIA ME QYTETARIN NË QENDËR

**për të shkallëzuar  
investimin në atë që  
funksionon për ta  
realizuar OZhQ-në  
16.3 në Kosovë**







**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

# DREJTËSIA ME QYTETARIN NË QENDËR

**për të shkallëzuar  
investimin në atë që  
funksionon për ta  
realizuar OZhQ-në  
16.3 në Kosovë**



Autorë: Gzim Shala, Arrita Reznici, Astrit Kolaj dhe Florian Smajli

Redaktorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të shtypet, kopjohet, shumëzohet në asnjë formë elektronike apo të shtypur, apo në ndonjë formë tjetër të shumëzimit, pa pëlqimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD-së), me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID-it), përmes Projektit të USAID-it për Drejtësi.

Pikëpamjet e autorëve në këtë raport nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it apo të qeverisë së SHBA-ve.

Shtator, 2024

## Përmbajtja

|        |   |    |
|--------|---|----|
| 1.     | Hyrje dhe historik.....   | 6  |
| 2.     | Kufizimi i kërimit.....   | 9  |
| 3.     | Përkufizimi i drejtësisë me qytetarin në qendër në Kosovë ..... | 9  |
| 4.     | Kostoja e shërbimeve të drejtësisë .....                        | 12 |
| 5.     | Boshllëqet dhe nevojat .....                                    | 15 |
| 5.1.   | Ndërmjetësimi si shërbim themelor .....                         | 15 |
| 5.2.   | Ndihma juridike .....   | 16 |
| 5.3.   | Mungesat në gjyqësor .....                                      | 18 |
| 5.3.1. | Mungesa e gjyqtarëve.....                                       | 20 |
| 5.3.2. | Mungesa e bashkëpunëtorëve profesionalë.....                    | 21 |
| 5.4.   | Mosthemelimi i degëve të reja të gjykatave .....                | 21 |
| 5.5.   | Mungesa e përkthimit.....                                       | 22 |
| 5.6.   | Miratimi i ligjeve pa buxhet të dedikuar .....                  | 23 |
| 6.     | Analiza kosto-përfitim.....                                     | 24 |
| 7.     | Përfundime .....  | 26 |
| 8.     | Rekomandimet .....  | 27 |

## I. Hyrje dhe historik

Kosova duke dalë nga një sfond kompleks historik dhe politik, ndodhet në një udhëkryq tejet të rëndësishëm të zhvillimit të një shoqërie të drejtë dhe të barabartë. Krijimi i një sistemi të drejtësisë me qytetarin në qendër është tejet i rëndësishëm në këtë rrugëtim. Ky dokument i politikës synon të eksplorojë dhe propozojë strategji për financimin dhe zbatimin e një sistemi të drejtësisë në Kosovë që nuk është vetëm efektiv, por edhe i rrënjësor në nevojat dhe realitetet e qytetarëve të saj.

Rëndësia e drejtësisë me qytetarin në qendër, në Kosovë nuk mund të mbivlerësohet. Një qasje ndaj drejtësisë me qytetarin në qendër u jep përparësi nevojave dhe të drejtave të individëve, veçanërisht të atyre që janë më të cenueshmit apo më të marginalizuarit. Koncepti synon ta bëjë drejtësinë të qasshme, të përballeshme dhe të kuptueshme për të gjithë qytetarët, duke siguruar që sistemi i drejtësisë të jetë mjet për fuqizim e jo burim i tjetërsimit.

Për t'i parandaluar dhe menaxhuar krizat në mënyrë efektive, për ta forcuar sundimin e ligjit dhe për t'i mbrojtur të drejtat e qytetarëve, shërbimet dhe institucionet e drejtësisë duhet të jenë të përgjegjshme, lehtësisht të qasshme dhe të afta për të ofruar shërbime ligjore të cilësisë së lartë për të gjithë, veçanërisht për pjesëtarët më të cenueshëm të shoqërisë.<sup>1</sup> Kështu, një qasje ndaj transformimit të sistemeve të drejtësisë me qytetarin në qendër ka ndikim të thellë, sepse e ripërkufizon thelbin e asaj që do të thotë drejtësi.

Drejtësia me qytetarin në qendër ka të bëjë me sistem të drejtësisë që e vë qytetarin në radhë të parë dhe që mëton t'i trajtojë nevojat e çdo pjesëtari të komunitetit në mënyrë të drejtë, duke e lehtësuar përfshirjen dhe angazhimin aktiv të tyre në sistemin ligjor. Pra, duke e nxjerrë në pah anën njerëzore të procedurave ligjore, duke pranuar se personat që marrin pjesë në sistemin gjyqësor kanë kërkesa përtej zbatimit të thjeshtë të ligjit. Pjesëmarrja e mirëfilltë e tyre në sistemin e drejtësisë do t'i kontribuojë efikasitetit të përgjithshëm të proceseve dhe rezultateve të drejtësisë. Shërbimet që i ofron sistemi i drejtësisë duhet të jenë lehtësisht të qasshme për të gjithë.

Në korrik të vitit 2022, Instituti i Kosovës për Qeverisje Lokale, me mbështetjen e USAID-it, e ka publikuar raportin “Harta e Drejtësisë në Komunitet në Kosovë”. Sipas këtij raporti, në shumë raste, palët mund të mos arrijnë që t'i përmbushin afatet ligjore për shkak të vetëdijes së kufizuar lidhur me institucionet përgjegjëse për t'i trajtuar të drejtat e tyre. Në raport thuhet se të anketuarit janë pyetur për arsyt e mosveprimit të tyre për t'i zgjidhur problemet. Rreth 9,38% e tyre kanë theksuar se nuk kanë ndërmarrë veprime për shkak të vonesave të ndryshme, 3,13% mendojnë se nuk ka institucione apo organizata që ofrojnë ndihmë juridike falas. Ndërsa, 14,1% janë përpjekur që të marrin këshilla, por nuk kanë marrë, 4,6% e tyre kanë deklaruar se nuk kanë mjaft para, ndërsa 29,7% e të anketuarve nuk e kanë ditur se ku kanë mundur që kërkojnë këshilla. Në të njëjtën kohë, 4,6% e tyre kanë deklaruar se nuk kanë

---

<sup>1</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, *Programi global për forcimin e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, drejtësisë dhe sigurisë për paqe dhe zhvillim të qëndrueshëm, Qasja në Drejtësi*, shih vegëzën: [https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2022-11/UNDP\\_GP\\_Justice.pdf](https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2022-11/UNDP_GP_Justice.pdf) (hapur së fundi më 16 shkurt 2024).

pasur kohë, ndërsa 34,4% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë besuar se do t'u ishte ofruar ndihmë.<sup>2</sup>

Sipas të dhënave që janë paraqitur në këtë raport, 20,44% e të anketuarve janë shprehur se kanë ndërmarrë veprime në rastet kur janë përballur me probleme ligjore. Shumica e të anketuarve, apo 36%, kanë deklaruar se në rastet kur janë përballur me probleme ligjore kanë shkuar në polici, 33,3% janë konsultuar me avokatë, ndërsa 22,67% kanë shkuar në gjykatë. Në anën tjetër, 10,67% të tjerë kanë kërkuar ndihmë nga miqtë, 17,33% kanë shkuar në institucionet komunale dhe 18,67% në institucionet qendrore. Është dukshëm e ulët shkalla e kënaqshmërisë në mesin e të anketuarve kur ata angazhohen me institucionet shtetërore apo subjektet e tjera.

Kjo e dhënë e vë në pah domosdoshmërinë e orientimit të drejtësisë kah qytetarët, duke e trajtuar atë si shërbim themelor që duhet të jetë lehtësisht i qasshëm dhe i informuar mirë për të gjithë. Kështu, përtej ndërtimit të mekanizmave ligjorë dhe zgjidhjeve të ndryshme procedurale, fokusi duhet të jetë në orientimin e drejtësisë si shërbim për qytetarët.

Fillimisht, të dhënat që janë paraqitur më lart janë shqetësuese, sepse shumë qytetarë nuk kanë kurrfarë informatash se ku mund të kërkojnë ndihmë për problemet ligjore të tyre. Megjithatë, sfidën më të madhe në fushën e drejtësisë civile në Kosovë e shkakton kohëzgjatja e shqyrtimit të lëndëve civile, posaçërisht në rastet kur kërkohet ndihma nga gjykatat.

Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore është njëri nga aspektet kryesore që e shkel të drejtën e qasjes së qytetarëve në drejtësi. Disa raporte për monitorimin e kësaj fushe nxjerrin në pah probleme të ndryshme në procedurat e lëndëve civile. Megjithatë, pothuajse të gjitha këto raporte e identifikojnë zgjatjen e procedurave civile si shqetësim të madh, meqë kjo e cenon të drejtën e qytetarëve për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Gjatë vitit 2022, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka pranuar gjithsej 1595 ankesa, 970 nga të cilat kanë pasur të bëjnë me të drejtën në mjete juridike dhe të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.<sup>3</sup> Kjo e fundit kishte përfshirë shqyrtimin e lëndës brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Ndër të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën nënvizon se “koha për marrjen e aktgjykimeve (d.m.th koha mesatare nga paraqitja e një çështjeje gjyqësore deri në marrjen e një vendimi) mbetet shkak për shqetësim, pasi ajo në përgjithësi është shumë e gjatë.<sup>4</sup> Në vitin 2022, koha e zgjidhjes ka qenë 690 ditë për çështjet civile në shkallën e parë<sup>5</sup>, ndërsa për vitin 2023 koha e zgjidhjes është ngritur në 763 ditë në shkallën e parë.<sup>6</sup> Në Strategjinë për Sundimin e Ligjit, ndër të tjera thuhet se “nga lëndët e grumbulluara, veçanërisht problematike është kohëzgjatja e lëndëve civile.”<sup>7</sup>

<sup>2</sup> Instituti i Kosovës për Qeverisje Lokale, *Harta e Drejtësisë në Komunitet në Kosovë*, 2022, fq.17.

<sup>3</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor 2022*, fq.16, shih linkun në: [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2023/03/OIK\\_AnnualReport\\_alb\\_web\\_01\\_compressed.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2023/03/OIK_AnnualReport_alb_web_01_compressed.pdf) (hapur së fundi më 16 shkurt 2024).

<sup>4</sup> *Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit (Komisioni Evropian)*, *Raporti i Kosovës 2023*, fq. 21, shih linkun në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3\\_en?filename=SWD\\_2023\\_692\\_Raporti\\_i\\_Kosovës\\_0.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692_Raporti_i_Kosovës_0.pdf) (hapur së fundi më 16 shkurt 2024).

<sup>5</sup> Raporti i KGJK për vitin 2022.

<sup>6</sup> Raporti i KGJK për vitin 2023.

<sup>7</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, *Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026*, 2021, fq. 12.

Krahas të tjerave, numri i madh i lëndëve civile ka qenë njëra nga arsyt kryesore të vonesave në shqyrtimin e lëndëve civile. Që nga viti 2018, numri i lëndëve civile të vjetra është rritur vazhdimisht. Përderisa në vitin 2021 kanë qenë gjithsej 85,087 lëndë të pazgjidhura që janë bartur në vitin pasardhës, viti 2022 ka shënuar rekord për sa i përket rritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura që janë bartur vit pas viti, me 99,407 lëndë të pazgjidhura. Prandaj, rritja e numrit të lëndëve të pranuar ka pasur ndikimin më të madh.<sup>8</sup> Ndërsa në vitin 2023 ky numër është rritur në 112623.<sup>9</sup>

Për këto arsye, ndër të tjera, për ta reduktuar periudhën kohore që nevojitet për shqyrtimin e lëndëve civile, është e nevojshme që të ndahet një buxhet i mjaftueshëm për t'i plotësuar nevojat e sistemit të drejtësisë. Kjo siguron që lëndët civile të shqyrtohen brenda një afati kohor të arsyeshëm, duke vënë drejtësi shpejt.

Për ta orientuar drejtësinë kah qytetari, financimi adekuat është thelbësor. Kjo e nënkupton krijimin e mekanizmave që qytetarët të kenë qasje të lehtë në shërbimet e drejtësisë, duke përfshirë shërbimet themelore dhe ato të vijës së parë, kur përballen me çështje ligjore. Në anën tjetër, në rastet kur të njëjtit persona i drejtohen Gjykatës, është e nevojshme që drejtësia atyre t'u ofrohet brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë aspekt, Kosova i ka marrë disa masa ligjore. Megjithatë, siç është shtjelluar edhe më tej në këtë raport, shumë nga këto zgjidhje nuk janë zbatuar për shkak të kufizimeve financiare.

Për ta avancuar orientimin e drejtësisë me qytetarin në qendër, financimit adekuat duhet t'i paraprijnë analizat e plota. Këto vlerësime duhet t'i vlerësojnë nevojat dhe efektivitetin e masave të propozuara, duke u siguruar që fondet e ndara t'u sjellin dobi maksimale qytetarëve. Forcimi i drejtësisë dhe përmirësimi i kapaciteteve njerëzore për të pasur qasje në drejtësi siguron që sundimi i ligjit të zbatohet në mënyrë të paanshme, duke e nxitur zhvillimin social dhe ekonomik<sup>10</sup>. Megjithatë, jo shumë njerëz mund të kenë qasje në informata, këshilla apo përfaqësim në zgjidhjen e problemeve të tyre. Kjo pengesë mund të jetë për shkak të kufizimeve financiare apo mungesës së përgjithshme të sistemeve. Megjithatë, një pengesë tjetër që ndikon në efikasitetin e ofrimit të shërbimeve dhe e kufizon qasjen edhe më shumë buron nga kapacitetet e kufizuara të qeverisë. Kjo mungesë e kapaciteteve në vendet pas konfliktit mund të burojë ose nga mungesa e burimeve financiare, ose nga mungesa e vullnetit të qeverisë.<sup>11</sup>

Rrjedhimisht, financimi i qeverisë për shërbimet ligjore është thelbësor për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga situata socio-ekonomike. Ky financim është veçanërisht i rëndësishëm për grupe të caktuara, duke përfshirë individët me të ardhura të ulëta, komunitetet e marginalizuara dhe viktimat e diskriminimit, duke i fuqizuar ata për t'i ushtruar të drejtat e tyre dhe për të kërkuar drejtësi. Kjo për shkak se qasja në drejtësi është më e kufizuar për këto grupe specifike. Në anën tjetër, edhe shpenzimet e qeverisë për

<sup>8</sup> Aurela Merlaku dhe Nuraje Bllaca, *Drejtësia civile*, fq. 5-7, shih linkun në: [https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-final-Drejtësia-civile\\_2022-final.pdf](https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-final-Drejtësia-civile_2022-final.pdf) (hapur së fundi më 16 shkurt 2024).

<sup>9</sup> Raporti i KGJK për vitin 2023.

<sup>10</sup> Bosio, Erica, Ana Palacio Jaramillo, 2023, *Rritja e qasjes në drejtësi në mjediset e brishta*, Uashington DC: Banka Botërore, shih linkun në: <https://openknowledge.worldbank.org/server/api/core/bitstreams/67db7e01-058a-482a-b082-d78f98142e4c/content> (hapur së fundi më 16 shkurt 2024).

<sup>11</sup> Po aty, fq. 8.



shërbimet ligjore luajnë rol jetik në ruajtjen e demokracisë, meqë mbështetja financiare e aktorëve të zbatimit të ligjit është thelbësore për ruajtjen e sigurisë publike.<sup>12</sup>

Të siguruarit se çdo vend e ka të paktën një sistem themelor të drejtësisë duket se është aspiratë e arsyeshme për bashkësinë ndërkombëtare, sipas OZhQ 16.3. Shpenzimet janë më të ulëta se ato të sigurimit të qasjes në një sistem themelor të arsimit apo shëndetësor.<sup>13</sup>

## 2. Kufizimi i kërkimit

Puna në kostim që është përshkruar në këtë dokument është një përpjekje fillestare për ta përcaktuar shkallën e hendekut të financimit për një sistem themelor të drejtësisë dhe për ta parë përbalueshmërinë e tij. Kjo punë është larg të qenit e përsosur, ndërsa shihet qartë se ka hapësirë për një punë shumë më të hollësishme dhe më të plotë (siç është bërë në sektorin e shëndetësisë dhe atë të arsimit) që mbështetet në një gamë më të gjerë të tërësive të të dhënave.

Megjithatë, me këtë dokument synohet që të shtyhet përpara nevoja për krijimin e një platforme adekuate për vlerësimin e mangësive, vlerësimin e efektivitetit të kostos në drejtësi dhe gjetjen e zgjidhjeve me kosto efektive. Në këtë fazë, një vlerësim i thellë i kësaj natyre është i pamundur për disa arsye. Fillimisht, të dhënat e gjeneruara nga sistemi gjyqësor dhe ANJF-ja nuk janë të orientuara drejt këtij qëllimi, por janë të orientuara në drejtime të tjera (p.sh. në efikasitetin gjyqësor).

Prandaj, për ta bërë një vlerësim adekuat, sistemi gjyqësor dhe ANJF-ja duhet t'i përcaktojnë të dhënat e nevojshme për vlerësime të tilla dhe të sigurojnë që ato të gjenerohen vazhdimisht, në mënyrë që një vlerësim i plotë i kësaj natyre të jetë i realizueshëm dhe i lehtë për t'u bërë në vazhdimësi. Pasi të identifikohen këto të dhëna, me anë të një metodologjie standarde, sistemi gjyqësor dhe ANJF-ja duhet të nxjerrin përfundime të thukëta, të cilat duhet të trajtohen nga institucionet e tjera të zbatimit të ligjit. Në këtë mënyrë, kjo analizë e përgatitë terrenin për një vlerësim të tillë dhe synon ta ofrojë një bazë solide për zhvillimin e një platforme për hulumtime në të ardhmen.

## 3. Përkufizimi i drejtësisë me qytetarin në qendër në Kosovë

Rritja e qasjes në drejtësi me qytetarët në fokus thekson se edhe drejtësia, në mënyrën e saj, mund të shihet si shërbim për qytetarët, i ngjashëm me shërbimet shëndetësore apo arsimin. Pavarësisht dallimeve dhe synimeve që sektori i drejtësisë i ka në raport me shërbimet e tjera, ka elemente të cilat ky sektor mund t'i marrë nga sektorët e tjerë, siç është ai i shëndetësisë.

---

<sup>12</sup> *Inteligjenca e praktikës ligjore, financimi ligjor i qeverisë: Qasja në drejtësi dhe ndryshim*, shih linkun në: <https://www.legalpracticeintelligence.com/blogs/practice-intelligence/government-legal-funding-access-to-justice-and-change> (hapur së fundi më 16 shkurt 2024).

<sup>13</sup> Clare Manuel dhe Marcus Manuel, Raporti i ODI-së, *Si të financohet qasja universale në drejtësinë me në qytetarin qytetarin në qendër: Shkallëzimi i inovacionit lokal për të e mos askënd prapa*, par. 30, shih linkun në: [https://odi.cdn.ngo/media/documents/How\\_to\\_finance\\_universal\\_access\\_to\\_people-centred\\_justice.pdf](https://odi.cdn.ngo/media/documents/How_to_finance_universal_access_to_people-centred_justice.pdf) (hapur së fundi më 16 shkurt 2024).

Kjo bëhet duke e bartur bilancin e resurseve nga reforma e gjerë dhe ndërtimi i kapaciteteve institucionale tek shërbimet e vijës së parë, në mënyrë që ofrimi i shërbimeve të drejtësisë të rritet në nivel vendi dhe të gjithë të kenë qasje në këto shërbime.<sup>14</sup> Në këtë kontekst, bëhet dallim midis shërbimeve themelore dhe shërbimeve të vijës së parë.

Qëllimi i përkufizimit të shërbimeve themelore të drejtësisë është që të gjithë të kenë qasje në këto shërbime. Krijimi i këtij koncepti bazohet në shërbimet shëndetësore themelore. Në këtë kuptim, sistemet joformale dhe alternative të zgjidhjes së problemeve ligjore përfshihen si shërbime themelore të drejtësisë, ndërkohë që vetëm problemet dhe ankesat më serioze kërkojnë trajtim nga gjykatat.

Në rastin e Kosovës, zgjidhja e mosmarrëveshjeve nëpërmjet mekanizmave alternativë, siç është ndërmjetësimi, mund të konsiderohet shërbim i kësaj natyre. Nëpërmjet kësaj procedure, palët mund t'i zgjidhin problemet e tyre ligjore me kosto të ulët dhe në mënyrë joformale, pa pasur nevojë që të shkojnë në gjykatë. Në rastet kur zgjidhja e problemit përfundon me procedurë të ndërmjetësimit, kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e përshtatshme për zbatim.<sup>15</sup> Pra, kjo marrëveshje është e barasvlershme me vendimin e gjykatës, edhe pse është joformale.

Për ta ngritur shkallën e ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit, është esenciale që të ekzistojnë zyra të ndërmjetësimit dhe që, në veçanti, publiku të informohet për këtë mundësi. Zgjidhja e çështjeve me anë të ndërmjetësimit ua mundëson palëve që lëndët e tyre t'i zgjidhin në mënyrë joformale dhe efikase, pa pasur nevojë që të kalojnë nëpër procedurë gjyqësore zyrtare, të kushtueshme dhe të gjatë. Në anën tjetër, investimi në këtë fushë është shumë i dobishëm për sistemin e drejtësisë, meqë e zbut trysninë mbi këtë sistem dhe nuk e rëndon atë me lëndë të tjera, prandaj lëndët e tjera zgjidhen në një afat kohor më të shkurtër.

Në anën tjetër, për ta ngritur drejtësinë në një shkallë më të lartë, në rastet kur ka nevojë për vendime gjyqësore, secila nga shtatë (7) gjykatat themelore në Kosovë i ka degët e veta, në të cilat mund të zgjidhen të gjitha lëndët civile.<sup>16</sup> Qëllimi është që qytetarët të jenë sa më afër gjykatës, aspekt që paraqet rritje të qasjes të qytetarëve në drejtësi. Krahas kësaj, zgjidhja e lëndëve në degët e gjykatave e ulë ngarkesën me lëndë në selitë e gjykatave themelore.

Në anën tjetër, për ta rritur qasjen në drejtësi, duke e përqendruar drejtësinë në qytetarët, është e rëndësishme që të sigurohet vija e parë e shërbimeve të drejtësisë. ODI-ja konsideron se shërbime të tilla mund të konsiderohen: 1) këshillat juridike, ndihma juridike dhe zgjidhjet joformale të konflikteve për komunitete dhe individë, e të cilat konflikte mund të jenë civile, penale apo administrative. Mund të jenë gjithashtu 2) këshilla dhe ndihmë juridike për grupet veçanërisht të marginalizuara dhe të cënueshme ndaj shkelësve të të drejtave të njeriut, siç janë të burgosurit.<sup>17</sup>

---

<sup>14</sup> Po aty, fq. 9-10.

<sup>15</sup> Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësimin, neni 8, 11 dhe 14.

<sup>16</sup> Ligji Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, neni 9.2.

<sup>17</sup> Clare Manuel dhe Marcus Manuel, Raporti i ODI-së, *Si të financohet qasja universale në drejtësinë me qytetarin qytetarin në qendër: Shkallëzimi i inovacionit lokal për të mos e lënë askënd prapa*, par. 13, shih linkun në: [https://odi.cdn.ngo/media/documents/How\\_to\\_finance\\_universal\\_access\\_to\\_people-centred\\_justice.pdf](https://odi.cdn.ngo/media/documents/How_to_finance_universal_access_to_people-centred_justice.pdf) (hapur së fundi më 16 shkurt 2024)

Në rastin e Kosovës, mund të konsiderohet se shërbimet juridike të vijës së parë ofrohen si nga avokatët, ashtu edhe nga Agjencia për Ndhmë Juridike Falas (ANJF-ja), si dhe organizatat e shoqërisë civile kur hyjnë në partneritet me ANJF-në. Në kuadër të ANJF-së funksionojnë zyrat rajonale. Sipas Ligjit, zyrat rajonale e mbulojnë ofrimin e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ndërsa ato janë të obliguara që të ofrojnë ndihmë juridike falas në komunat të cilat i mbulon zyra rajonale përkatëse, përmes zyrave mobile. Ndërkaq, zyrat mobile për ndihmë juridike falas, si formë e organizimit të shërbimeve juridike, veprojnë në komunat në të cilat zyrat e ndihmës juridike falas nuk janë themeluar.<sup>18</sup>

Zyrat rajonale të ndihmës juridike janë të obliguara që të ofrojnë ndihmë juridike falas në komunat që i mbulon ajo zyrë rajonale, përmes zyrave mobile. Në vitin 2018, me mbështetjen e UNDP-së, dy zyrtarë të tjerë të ndihmës juridike janë punësuar për katër muaj për zyrat mobile të ndihmës juridike në komunat e Drenasit, Malishevës, Podujevës dhe Graçanicës. Me mbështetjen e Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim Ndërkombëtar (GIZ-it), Agjencia i ka punësuar edhe katër zyrtarë të ndihmës juridike, të cilët u kanë ofruar mbështetje dhjetë komunave të Kosovës, përkatësisht në Fushë Kosovë, Drenas, Istog, Pejë, Suharekë, Dragash, Mitrovicë, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. ANJF-ja vazhdimisht ka vështirësi që ta arrijë mbulimin e plotë me shërbime, për shkak të mungesës së buxhetit. Një kritikë që e ka bërë USAID-i lidhur me atë që u tha më lart është se këto zyra mobile janë hapur për periudha të shkurtra dhe nuk janë bazuar në ndonjë vlerësim paraprak të nevojës për mbulim territorial. Mbështetja e donatorëve kanalizohet në bazë të Planit Strategjik të ANJF-së 2015-2019 dhe çdo dy muaj mbahen takime të rregullta për koordinimin e donatorëve, ku shprehen rregullisht nevojat e ANJF-së. Ekziston nevoja që ky financim të vazhdojë derisa autoritetet kosovare të sigurojnë resurse adekuate për t'i përmbushur nevojat ligjore të qytetarëve të tyre.<sup>19</sup>

Me fjalë të tjera, sipas Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas [neni 26], përveç zyrave rajonale, ofruet të ndihmës juridike falas janë edhe avokatët dhe organizatat joqeveritare në rastet kur hyjnë në partneritet me Agjencinë e Ndhmës Juridike Falas. Për sa i përket dhënies së ndihmës juridike falas nga organizatat e shoqërisë civile, Ministria e Drejtësisë tashmë e ka miratuar Rregulloren Nr. 05/2023, e cila i përcakton kriteret për ofrimin e ndihmës juridike falas nga organizatat joqeveritare në partneritet me ANJF-në. Që nga atëherë janë shtatë (7) OJQ në Kosovë që i kanë plotësuar kriteret për ofrimin e ndihmës juridike falas dhe e kanë të mundur ofrimin e ndihmës juridike falas.

Duke e marrë parasysh qëllimin e shërbimeve juridike të vijës së parë për ndikimin e drejtpërdrejtë në OZhQ 16.3, këto shërbime, për sa i përket trajtimit dhe parandalimit të shkeljes së të drejtave të njeriut, u dedikohen edhe të paraburgosurve ndaj të cilëve nuk janë shqiptuar dënime dhe të cilët janë mbajtur në paraburgim përtej një kohe të arsyeshme (16.3.2). Në çështjet penale, në rastin e Kosovës, juridikisht, për shkak të kësaj situatë, çështja e të paraburgosurve nuk duket të jetë shumë kundërthënëse. Sipas Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, i pandehuri duhet patjetër të ketë mbrojtje nga arrestimi, gjatë seancës

<sup>18</sup> Ligji Nr. 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas, neni 22, par 1-2 dhe neni 28.

<sup>19</sup> Ministria e Drejtësisë, *Rritja e qasjes në gjykata dhe prokurori, rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë*, 2019, fq. 17.

për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim.<sup>20</sup> Pra, ndihma juridike në këtë rast, sipas Ligjit, duhet të ofrohet.

Si përfundim, në kontekst të drejtësisë me qytetarin në qendër, Ligji i njeh si shërbimet themelore, ashtu edhe shërbimet e vijës së parë. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që, ndër të tjera, fokusi të jetë në këto fusha. Qëllimi përfundimtar ka qenë që të evitohet problemi kryesor i drejtësisë civile në Kosovë, e që është kohëzgjatja e procedurave civile.

#### 4. Kostoja e shërbimeve të drejtësisë

Nga viti 2021 deri në vitin 2024, buxheti për sistemin e drejtësisë është rritur vazhdimisht. Krahasuar me vitin 2021, buxheti për vitin 2024 është 6,612.318 euro më i lartë. Gjithsej kostoja e gjyqësorit, për vitin 2024, ka qenë 35,806.910 euro.

Në vitin 2023, buxheti i përgjithshëm i gjyqësorit, duke përfshirë donacionet, ka qenë 32,888,599.39€, ndërsa shpenzimet e KGJK-së kanë qenë 30,781,797.84€. Kjo do të thotë se KGJK-ja e ka shfrytëzuar 93,59% të buxhetit të ndarë. Shkalla më e ulët e shpenzimeve është vërejtur në kategorinë e donacioneve, me 62,85%, pasuar nga shpenzimet kapitale, me 66,77%.<sup>21</sup>

Megjithatë, rritja e përgjithshme e shpenzimeve të qeverisë sipas ligjeve për ndarjen e buxhetit nuk është pasqyruar proporcionalisht as në sistemin gjyqësor. Në vitin 2021 dhe 2022, pjesëmarrja e buxhetit të sistemit të drejtësisë në shumën totale të shpenzimeve të qeverisë ka qenë 1,2%. Në anën tjetër, kjo përqindje ka rënë në 1.1% në vitin 2023 dhe 2024. Po ashtu, edhe krahasuar me shpenzimet buxhetore për institucionet qendrore, përqindja e buxhetit të sistemit të drejtësisë është ulur në vitin 2024 krahasuar me vitin 2022.

Nëse në vitin 2024 pjesëmarrja e gjyqësorit në buxhet do të kishte mbetur në përqindjen 1.2%, atëherë sistemi i drejtësisë do të kishte gjithsej 3,820.966 euro më shumë.

Kërkesa buxhetore e KGJK-së, e cila nuk është aprovuar nga Kuvendi me Ligjin Nr. 08/L-260 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024), ka qenë 7,629.161 euro. Për ta përmbushur këtë kërkesë, atëherë pjesëmarrja e gjyqësorit në buxhetin e përgjithshëm të shtetit duhet të jetë rreth 1.27%.

<sup>20</sup> Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 56.1.1.2.

<sup>21</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti i Punës për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Kosovës 2023, f.73, shih linkun në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/40736\\_KGJK\\_RAPORTI\\_VJETOR\\_2023.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/40736_KGJK_RAPORTI_VJETOR_2023.pdf) (hapur së fundi më 8 shtator 2024).


| Gjithsej buxheti |            | Përqindja në lidhje me shpenzimet e përgjithshme të planifikuara | Përqindja në raport me shpenzimet e planifikuara për institucionet qendrore |
|------------------|------------|--|---|
| <b>2021</b>      | 29,194,592 | 1.20%  | 1.20%   |
| <b>2022</b>      | 32,183,896 | 1.20%  | 1.50%   |
| <b>2023</b>      | 34,155,572 | 1.10%  | 1.40%   |
| <b>2024</b>      | 35,806,910 | 1.10%  | 1.40%   |

**Tabela I. Buxheti për sistemin e drejtësisë gjatë viteve 2021-2024.**

Kështu, krahasuar me popullsinë e Republikës së Kosovës,<sup>22</sup> buxheti vjetor për gjyqësorin është 22,9 euro për kokë banori.


Krahasuar me kujdesin shëndetësor parësor dhe arsimin fillor, buxheti i gjyqësorit është dukshëm më i ulët. Për shembull, sipas Ligjit Nr. 08/L-260 për Ndarjet Buxhetore për Republikën e Kosovës për vitin 2024, buxheti për shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, duke i përjashtuar investimet kapitale të nivelit qendror, është 91,266.064€ në të gjitha komunat. Kjo është barazi me 57,52 € për kokë banori për shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor. Po ashtu, buxheti për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, pa i përfshirë investimet kapitale të nivelit qendror, arrin në 175,615.092€. Kjo rezulton në 110,68 € për kokë banori për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, pa i përfshirë shpenzimet kapitale. Prandaj, buxheti për kujdesin shëndetësor parësor është më shumë se dyfishi i atij të gjyqësorit, ndërsa buxheti për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është përafërsisht pesë herë më i lartë se ndarja buxhetore për gjyqësorin.

<sup>22</sup> Koha, Kosova me 1,586.659 banorë, 12 qershor 2024, shih linkun në: [https://www.koha.net/arberi/425890/kosova-me-1586659-banore-rezident?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTEAARlXcsxjCqs8nNjFgfU5Jgxb8XvExLKV3G00000jgxbguCv60LVGNj\\_aem\\_Da8B1F-ma2rgrsUuoltWdg](https://www.koha.net/arberi/425890/kosova-me-1586659-banore-rezident?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTEAARlXcsxjCqs8nNjFgfU5Jgxb8XvExLKV3G00000jgxbguCv60LVGNj_aem_Da8B1F-ma2rgrsUuoltWdg) (hapur së fundi më 8 shtator 2024).



**Grafika 1. Krahasimet e buxhetit vjetor për kokë banori, për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor, arsimin fillor dhe të mesëm të ulët dhe gjyqësorin.**

Për sa i përket Agjencisë së Ndhmës Juridike Falas, nga viti 2021 deri në vitin 2023, rritja ka qenë pothuajse e papërfillshme. Rritja më e konsiderueshme e buxhetit për këtë agjenci ka ndodhur në vitin 2024, duke e paraqitur një rritje prej 21,08% krahasuar me një vit më parë. Në krahasim me numrin e banorëve, buxheti i ANJF-së për vitin 2024 është vetëm 33 cent për person.



**Grafika 2. Gjithsej buxheti i Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas gjatë viteve 2021-2024.**

Në anën tjetër, ndihma juridike në çështjet penale, në rastet kur mbrojtja sigurohet përmes të hyrave publike, nuk është përfshirë në këtë kosto. Kjo për shkak se pagesa për këtë bëhet përmes buxhetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, për avokatët e angazhuar.

## 5. Boshllëqet dhe nevojat

### 5.1. Ndërmjetësimi si shërbim themelor

Në kuadër të shërbimeve themelore, të cilat janë shtjelluar më parë në këtë raport, ndërmjetësimi konsiderohet shërbim shumë adekuat që qytetarët t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre në mënyrë joformale dhe tejet efektive, pa pasur nevojë që lëndët e tyre të shqyrtohen në gjykatë.

Gjatë vitit 2023, për procedurë të ndërmjetësimit janë referuar gjithsej 10,864 lëndë, 8,925 nga të cilat janë zgjidhur, ndërsa lëndët e tjera kanë mbetur në procedurë. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, 6,037 lëndë janë referuar nga gjykatat, ndërsa 2,793 nga prokuroritë. Në anën tjetër, me iniciativën e palëve, jashtë gjykatave dhe prokurorive, janë iniciuar 2,034 lëndë.<sup>23</sup>

Krahasuar me numrin e lëndëve civile të pranuar nga gjykatat, numri i lëndëve të iniciuara nga vetë palët për procedurë të ndërmjetësimit rezulton të jetë shumë i ulët. Në vitin 2023, gjykatat i kanë pranuar 44,575 lëndë civile kontestimore, që tregon se qytetarët u janë drejtuar gjykatave për afro 22 herë më shumë se sa që kanë iniciuar procedura të ndërmjetësimit.

Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i procedurës së ndërmjetësimit, si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve, është rrjedhojë e mungesës së vetëdijes së qytetarëve për këtë procedurë dhe për avantazhet e saj, siç është konstatuar në procesin e rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit. Prandaj, është rekomanduar që të gjithë aktorët relevantë ta ngritin vetëdijen e publikut për procedurën e ndërmjetësimit dhe për dobitë e kësaj procedure për qytetarët në mënyra të ndryshme.<sup>24</sup>

Në anën tjetër, siç u tha, ky shërbim themelor i drejtësisë është i rëndësishëm për t'u shkallëzuar në nivel vendi. Në rastin tonë, kjo do të thotë se ndërmjetësuesit dhe zyrat e ndërmjetësimit duhet të jenë të pranishme në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Me disa përjashtime, zyrat e ndërmjetësimit praktikisht mungojnë në shumicën e komunave të Republikës së Kosovës. Arsyeja kryesore për këtë janë të ardhurat modeste të ndërmjetësuesve, të cilët shpesh nuk mund ta mbajnë veten vetëm nëpërmjet ndërmjetësimit dhe zakonisht e ushtrojnë atë si profesion dytësor. Kjo është kryesisht për shkak të tarifave minimale që u paguhen ndërmjetësuesve, si dhe numrit të vogël të lëndëve që dërgohen për

---

<sup>23</sup> Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës, *Rastet e referuara dhe të zgjidhura me ndërmjetësim në vitin 2023*, 8 shkurt 2024, shih linkun në: <https://ndermjetesimi.com/rastet-e-referuara-dhe-te-zgjidhura-me-ndermjetesim-ne-vitin-2023/> (hapur së fundi më 8 shtator 2024).


<sup>24</sup> Ministria e Drejtësisë, *Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në profesionet që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë, Rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë*, 2019, fq. 34.

ndërmjetësim. Rrjedhimisht, nuk është ekonomikisht e qëndrueshme që ndërmjetësit të hapin zyra të ndërmjetësimit si profesionalë të pavarur.<sup>25</sup>

Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë duhet të ndërmarrë hapa proaktivë për t'i bashkërenduar përpjekjet me të gjithë aktorët relevantë dhe për ta rritur vetëdijen e publikut për procesin e ndërmjetësimit për zgjidhjen e lëndëve. Rritja e numrit të lëndëve për ndërmjetësim do t'i krijonte kushtet ekonomike të nevojshme për krijimin e zyrave të ndërmjetësimit në çdo komunë. Për t'i mbështetur këto nisma, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta ndajë një buxhet të mjaftueshëm pas analizimit të thukët të nevojave në këtë domen.

## 5.2. Ndhimja juridike

Siç u përmend, në kontekst të drejtësisë me qytetarin në qendër, ofrimi i ndihmës juridike konsiderohet si njëri nga shërbimet ligjore të vijës së parë. Në vitin 2022, ANJF-ja u ka ofruar ndihmë gjithsej 5861 qytetarëve, ku 2619 kanë qenë burra dhe 3242 gra. Gjatë vitit 2023, ANJF-ja u ka ofruar ndihmë juridike falas gjithsej 6081 qytetarëve, nga të cilët 3191 kanë qenë burra dhe 2890 kanë qenë gra.<sup>26</sup>



**Grafika 3. Numri i përfituesve të ndihmës juridike falas në 2022 dhe 2023.**


Duke e krahasuar gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka pasur rritje të numrit të qytetarëve që kanë marrë ndihmë juridike falas nga ANJF-ja.

<sup>25</sup> Intervistë me ndërmjetësuesin Yll Zekaj, 12 shkurt 2024.

<sup>26</sup> Agjencia e Ndhimës Juridike Falas, *Raporti Vjetor 2023*, par. 7.2 – 7.8, shih linkun në: <https://anjfq.rks-gov.net/desk/inc/media/7D82613F-8A95-4CF3-9DA4-BACB2E77696C.pdf>, par. 7.2 – 7.8 (hapur së fundi më 8 shtator 2024).



Në gjysmën e parë të vitit 2023, ANJF-ja u ka ofruar ndihmë juridike falas 3107 individëve (1717 burra dhe 1390 gra). Në gjysmën e parë të vitit 2024, ky numër është rritur në 4366, duke përfshirë 2485 burra dhe 1881 gra.



**Grafika 4. Numri i përfituesve të ndihmës juridike falas në gjashtë muajt e parë të 2023 dhe 2024.**

Në raportin “Harta e Drejtësisë në Komunitet” janë theksuar sfidat me të cilat është përballur Agjencia për Ndhmë Juridike Falas, e që në veçanti paraqiten si rrjedhojë e kufizimeve buxhetore. Sipas këtij raporti, kjo agjenci ende nuk ka siguruar financim të plotë për stafin e saj dhe për hapësirat e punës. Gjetjet e tjera të këtij hulumtimi tregojnë se stafi i Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas i është nënshtruar trajnimeve të vazhdueshme për ngritje të kapaciteteve të tyre. Megjithatë, një pengesë e madhe për komunikimin e tyre me grupet etnike të ndryshme është mungesa e njohurive për gjuhët e këtyre komuniteteve ose anasjelltas. Ky problem është identifikuar në komunat siç janë Skenderaj, Mitrovica dhe Prizreni.

Në Planin Strategjik të ANJF-së për periudhën 2021-2025 janë përvijuar qëllimet strategjike, duke përfshirë sigurimin e resurseve financiare për t’i përmbushur obligimet ligjore dhe për ta përmirësuar efikasitetin administrativ dhe financiar të ANJF-së.<sup>27</sup>

Kufizimet financiare me të cilat është përballur Agjencia për Ndhmë Juridike Falas kanë shkaktuar vështirësi në themelimin e zyrave mobile në të gjitha komunat e Kosovës, duke ndikuar kështu në ofrimin e ndihmës juridike për qytetarët. Themelimi i këtyre zyrave është obligim ligjor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas.<sup>28</sup> Për një periudhë

<sup>27</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025, Agjencia për Ndhmë Juridike Falas, fq. 5, shih linkun në: <https://anjfq.rks-gov.net/desk/inc/media/0B9C7876-CB7A-4871-A16F-D9BA6419E26D.pdf> (hapur së fundi më 18 shkurt 2024).

<sup>28</sup> Po aty, fq.2.

relativisht të gjatë, kufizimet buxhetore e kanë penguar këtë agjenci që ta zbatojë një dispozitë ligjore që është krijuar për ta sjellë këtë agjenci më afër qytetarëve, duke e penguar kështu qasjen në ndihmë juridike – element ky thelbësor i qëllimit më të gjerë të avancimit të qasjes në drejtësi. Që nga qershori i vitit 2024, ANJF-ja i ka hapur gjashtë (6) zyra mobile për ndihmë juridike falas.<sup>29</sup>

Sipas Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024, buxheti për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas është paraparë të jetë 537,831 euro. Kjo paraqet rritje të konsiderueshme prej 21,08% krahasuar me buxhetin e ndarë në vitin 2023.

Duke marrë parasysh rolin jetik të ndihmës juridike falas në sigurimin e qasjes në drejtësi për individët të cilët nuk mund t'u përballojnë shpenzimeve ligjore, është tejet e rëndësishme që buxheti i ANJF-së të ngritet në një nivel që ua mundëson atyre që t'i përmbushin të gjitha obligimet ligjore dhe të ofrojnë ndihmë juridike falas adekuate. Është esenciale që të parandalohet çdo kompromis për ofrimin e ndihmës juridike falas, e cila është aspekt themelor i sigurimit të qasjes në drejtësi, për shkak të kufizimeve financiare.


### 5.3. Mungesat në gjyqësor

Në vitin 2022, Gjykatat Themelore në Republikën e Kosovës i kanë gjykuar gjithsej 25,632 lëndë civile kontestimore, ndërsa i kanë pranuar 40,826 lëndë të kësaj natyre. Rrjedhimisht, këto gjykata nuk kanë mundur të zgjidhin aq lëndë sa kanë pranuar, çfarë ka rezultuar në gjithsej 99,407 lëndë të pazgjidhura deri në fund të vitit 2022.<sup>30</sup> Ky trend ka vazhduar në vitin 2023, pasi gjyqtarët i kanë marrë 53,767 lëndë civile kontestimore, por kanë arritur t'i zgjidhnin vetëm 38,554 lëndë të kësaj natyre. Rrjedhimisht, deri në fund të vitit 2023, numri i lëndëve civile kontestimore të pazgjidhura ka arritur në 112,623.

---

<sup>29</sup> Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, *Agjencia për Ndihmë Juridike Falas siguron shtrirjen e ndihmës juridike falas edhe në 6 (gjashtë) komuna të Republikës së Kosovës*, 5 gusht 2024, shih linkun në: <https://anjfq.rks.gov.net/page.aspx?id=1.2.272> (hapur së fundi më 8 shtator 2024).


<sup>30</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti statistikor i gjykatave 2022*, fq. 8, shih linkun në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114\\_RAPORTI\\_STATISTIKOR\\_I\\_GJYKATAVE\\_VJETOR\\_2022.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114_RAPORTI_STATISTIKOR_I_GJYKATAVE_VJETOR_2022.pdf) (hapur së fundi më 18 shkurt 2024).



**Grafika 5. Trajtimi i lëndëve civile kontestimore nga gjykatat themelore të Kosovës (2022 dhe 2023).**

Ndonëse ndryshojnë për nga shifrat, përfundimi është i njëjtë edhe nëse e krahasojmë gjashtëmuorin e parë të vitit 2023 me atë të vitit 2024. Gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2023 i kanë pranuar gjithsej 21,399 lëndë civile kontestimore, ndërsa i kanë zgjidhur 13,228 lëndë të kësaj natyre. Si rezultat, gjykatat nuk kanë arritur të zgjidhnin aq lëndë sa kanë marrë, duke çuar në një numër të lëndëve të vjetra të pazgjidhura në 106,738 lëndë civile kontestimore deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2023.

Në gjysmën e parë të vitit 2024, numri i lëndëve civile kontestimore të zgjidhura është rritur dukshëm. Megjithatë, për shkak të rritjes së numrit të lëndëve hyrëse, rezultati ka mbetur i pandryshuar. Gjatë kësaj periudhe, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, gjykatat kanë arritur t'i zgjidhin gjithsej 33,332 lëndë civile kontestimore. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe, gjykatat i kanë pranuar edhe 44,575 lëndë civile kontestimore të reja. Kështu, përkundër rritjes së numrit të lëndëve të zgjidhura, për shkak të rritjes eksponenciale të numrit të lëndëve të pranuar, gjyqësori përsëri nuk ka arritur të zgjidhë aq lëndë sa ka pranuar. Rrjedhimisht, numri i lëndëve civile kontestimore është rritur në 123,243 lëndë të pazgjidhura.



**Grafika 6. Shqyrtimi i lëndëve civile kontestimore nga gjykatat themelore të Kosovës, gjashtëmuajori i parë i vitit 2023 dhe 2024.**

Kështu, organet e drejtësisë nuk kanë mundur t'u përgjigjen kërkesave të qytetarëve. Kjo i atribuohet pamundësisë së gjykatës për të zgjidhur të paktën aq lëndë sa ka pranuar, çfarë ka çuar në një rritje të vazhdueshme të numrit të lëndëve civile të pazgjidhura. Në kaptinën I të këtij raporti është shtjelluar zvarritja e lëndëve gjyqësore civile, ndërsa kaptinat e pastajme janë thelluar në mangësitë financiare që e pengojnë aftësinë e sistemit gjyqësor për t'i trajtuar nevojat e qytetarëve.

### 5.3.1. Mungesa e gjyqtarëve

Numri i gjyqtarëve në sistemin gjyqësor është rritur për çdo vit. Mbështetja buxhetore për këtë nismë konsiderohet shumë pozitive, sepse siguron që gjyqësori të ketë resurse adekuat për t'i shqyrtuar lëndët gjyqësore brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Aktualisht në gjykatat e Kosovës janë gjithsej 434 gjyqtarë. Në mesin e tyre, 367 gjyqtarë kanë zgjidhur lëndë gjatë vitit 2023, ndërsa 145 gjyqtarë janë caktuar posaçërisht në divizionet civile të departamenteve të përgjithshme të gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit<sup>31</sup>. Megjithatë, që nga viti 2018, numri i lëndëve civile është dyfishuar. Përveç strategjive të tjera që e synojnë zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura (të cilat nuk janë mbuluar në këtë raport), rritja e numrit të gjyqtarëve është e domosdoshme për ta trajtuar këtë situatë në mënyrë efektive. Në kërkesën buxhetore të KGJK-së për vitin 2024, KGJK-ja ka kërkuar rritje

<sup>31</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti statistikor i gjykatave, gjysma e parë e vitit 2024*, shih linkun në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/81513\\_Raporti\\_i\\_pergjithshem\\_gjashtemuajori\\_2024\\_ALB.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/81513_Raporti_i_pergjithshem_gjashtemuajori_2024_ALB.pdf) (hapur së fundi më 10 shtator 2024).

të numrit të gjyqtarëve për 30 pozita. Kostoja buxhetore për miratimin e këtij propozimi është 512,568 euro. Por, kjo kërkesë është refuzuar nga Kuvendi gjatë miratimit të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024.

### 5.3.2. Mungesa e bashkëpunëtorëve profesionalë

Një nga masat për rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor është angazhimi i bashkëpunëtorëve profesionalë. Për shkak të rëndësisë së angazhimit të një bashkëpunëtori profesional, Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat [neni 39.2], i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019, përcakton se „[Ç]do gjyqtar duhet ta ketë së paku nga një bashkëpunëtor profesional, që i shërben ekskluzivisht gjyqtarit në fjalë”. Kjo dispozitë konsiderohet mjaft pozitive, sepse bashkëpunëtorët profesionalë do t’u ndihmojnë gjyqtarëve që ta rrisin cilësinë dhe efikasitetin e tyre gjatë shqyrtimit të lëndëve. Rrjedhimisht, qytetarëve do t’u ofrohej drejtësi më e shpejtë dhe më profesionale, çfarë do të çonte në qasje të avancuar të qytetarëve në drejtësi.

Megjithatë, kjo dispozitë ligjore nuk është shoqëruar me buxhetin e nevojshëm për plotësimin e këtyre pozitave. Pothuajse pesë (5) vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka mundur të rekrutojë numër të mjaftueshëm të bashkëpunëtorëve profesionalë, për shkak të mungesës së buxhetit. Aktualisht, sistemi gjyqësor e ka një mungesë prej 151 bashkëpunëtorësh profesionalë, që do të thotë se kërkesa ligjore për ta caktuar një bashkëpunëtor profesional të veçantë për secilin nga 151 gjyqtarët brenda sistemit gjyqësor mbetet e paplotësuar.

Në projektbuxhetin për vitin 2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës e ka inkorporuar kërkesën buxhetore për 151 bashkëpunëtorë profesionalë. Por, kjo kërkesë nuk është aprovuar nga Kuvendi në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024.

## 5.4. Mosthemelimi i degëve të reja të gjykatave

Me Ligjin Nr. 06/L-054 për Gjykatat, KGjK-ja është obliguar që të themelojë degë të reja të gjykatave, konkretisht degët në Fushë Kosovë, Obiliq, Ranillug, Partesh, Killokot, Verboc, Mamushë, Junik, Shtime dhe Hani të Elezit.<sup>32</sup> Sipas informatave të ofruara nga KGjK-ja, dega në Fushë Kosovë është themeluar dhe aktualisht është në proces të funksionalizimit. Sa i përket themelimit të degëve të tjera, KGjK-ja e ka sqaruar qasjen e saj, duke treguar se vendimet do të varen nga kufizimet buxhetore. Gjatë procesit të vendimmarrjes do të merren parasysh edhe faktorët siç janë numri i lëndëve dhe numri i banorëve në komunat përkatëse, ashtu si janë regjistruar zyrtarisht nga institucionet kompetente.<sup>33</sup>

<sup>32</sup> Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat, neni 9.

<sup>33</sup> Lavdim Makshana, *Sfidat në administratën gjyqësore*, fq. 16, shih linkun në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/Monitoring-of-the-KPC-report-for-2022-FINAL-12.04.2023-1.pdf> (hapur së fundi më 16 shkurt 2024)

Zbatimi i këtyre dispozitave ligjore për themelimin e degëve të lartpërmendura është kërkuar edhe nga rishikimi funksional i sektorit të zbatimit të ligjit në Kosovë.<sup>34</sup>

Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024 e ka identifikuar si aktivitet buxhetor konkretisht ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Shtime. Megjithatë, vlen të theksohet se për këtë aktivitet nuk është ndarë buxhet në vitin fiskal aktual. Në vend të kësaj, ekziston një plan për t'i ndarë 30,000 euro për këtë qëllim në vitin 2025. Në disa raste, aktivitetet që kanë të bëjnë me projektimin dhe ndërtimin e gjykatave ekzistuese janë renditur në buxhet, me fonde të ndara. Megjithatë, vërehet një mungesë e theksuar e ndarjeve buxhetore për ndërtimin e degëve të reja të gjykatave, përkundër obligimit ligjor për themelimin e tyre.

Kritikat kryesore për mosthemelimin e degëve të reja me gjasë bien mbi Kuvendin, kryesisht për shkak të ndarjeve buxhetore joadekuate për themelimin e këtyre degëve të reja. Megjithatë, pas analizimit të kërkesës buxhetore për vitin 2024, është evidente se KGjK-ja nuk e ka përfshirë çështjen e themelimit të degëve të reja të gjykatave në kërkesën e tij. Rrjedhimisht, gjyqësori nuk ka kërkuar asnjë buxhet shtesë për këtë qëllim.<sup>35</sup> Si rrjedhojë, kostoja për themelimin e këtyre degëve të gjykatave mbetet e panjohur.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka deklaruar se themelimi i degëve të reja do të varet nga mundësitë buxhetore, të cilat nuk janë kërkuar, dhe se për këtë do të merren në konsideratë edhe faktorët siç janë numri i lëndëve dhe numri i banorëve duke u bazuar në regjistrimin zyrtar nga institucionet kompetente. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se vlerësimi i nevojës për degë të reja të gjykatave nuk bie në kompetencë të KGjK-së. Sipas ligjit, përcaktohen komuna specifike ku duhet të krijohen degë të reja të gjykatave. Prandaj, KGjK-ja nuk ka kompetencë që ta përcaktojë domosdoshmërinë e themelimit të degëve të reja të gjykatave, nëse kjo është e përcaktuar me ligj. Kështu, mosparaqitja e kërkesave buxhetore nga KGjK-ja në Kuvend për themelimin e degëve të reja të gjykatave, obligim ky që buron pikërisht nga Ligji të cilin e ka miratuar Kuvendi, paraqet qasje joadekuate ndaj sistemit gjyqësor.

Kuvendi mund të konsiderohet përgjegjës për mosndarjen e buxhetit vetëm pas dorëzimit të kërkesës buxhetore për themelimin e degëve të reja të gjykatave nga ana e KGjK-së.

## 5.5. Mungesa e përkthimit

E drejta e palëve në procedurë për t'i ndjekur procedurat gjyqësore në një gjuhë që ata e kuptojnë është njëri nga komponentët themelorë të parimit të qasjes në drejtësi. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës [neni 5.1] “[gjuhët] zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe”. Në anën tjetër, palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që gjatë procedurës që zhvillohet në gjykatë ta përdorin gjuhën e

<sup>34</sup> Ministria e Drejtësisë, *Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, Rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë, 2019, fq. 74.*

<sup>35</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Kërkesa për buxhetin e vitit 2024 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës sipas Qarkores Buxhetore 2024/01 dhe kërkesat shtesë, qershor 2023.*

vet apo një gjuhë të cilën e kuptojnë. Shpenzimet e përkthimit mbetën në ngarkim të buxhetit të gjykatës.<sup>36</sup>

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023 nënvizon se “Kosova duhet të vazhdojë të sigurojë që procedurat gjyqësore të jenë të qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare, siç kërkohet me Kushtetutë. Janë rekrutuar përkthyes gjyqësorë të tjerë, ndërsa KGJK-ja është në proces të krijimit të një platforme për centralizimin e përkthimeve në gjykata. Megjithatë, nevojiten më shumë përpjekje për ta trajtuar mungesën e përkthyesve të kualifikuar, edhe me qëllim të zvogëlimit të numrit të lëndëve të pazgjidhura”.<sup>37</sup> Në analizën që e ka bërë Instituti i Kosovës për Drejtësi, duke u bazuar në kriteret e Komisionit Evropian për Efikasitet të Drejtësisë, është shqyrtuar kënaqshmëria e përdoruesve të gjykatave dhe avokatëve, sipas vlerësimit të Këshillit të Evropës. Në këtë analizë janë identifikuar raste kur palëve në procedurë nuk u janë ofruar shërbime të përkthimit kur procedurat gjyqësore nuk janë zhvilluar në gjuhën amtare të tyre.<sup>38</sup>

Për t’i përmbushur këto obligime, sistemi gjyqësor duhet të ketë resurse të mjaftueshme. Në kërkesën buxhetore për vitin fiskal 2024, KGJK-ja e ka futur një kërkesë për financim shtesë për t’i mbuluar 10 pozita për përkthyes. Kostoja në lidhje me përmbushjen e kësaj ka qenë afërsisht 452,000 euro. Kjo kërkesë nuk është aprovuar nga Kuvendi dhe nuk është përfshirë në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024.

## 5.6. Miratimi i ligjeve pa buxhet të dedikuar

Në mjaft raste, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligje që përbëjnë avancim të qasjes së qytetarëve në drejtësi. Megjithatë, zbatimi i këtyre ligjeve ka sjellë kosto shtesë. Fatkeqësisht, në jo pak raste, Kuvendi ka qenë i kënaqur me miratimin e këtyre ligjeve, por nuk ka ndarë buxhet të mjaftueshëm që këto ligje të zbatohen në praktikë. Rrjedhimisht, përdërisa ka dispozita të lavdërueshme në letër, mungon zbatimi i tyre në praktikë.

Një shembull i kësaj është Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat. Siç u shpjegua më lart, për shkak të mungesave buxhetore, dispozitat që kanë të bëjnë me themelimin e degëve të tjera të gjykatave dhe kërkesa që secili gjyqtar ta ketë një bashkëpunëtor profesional nuk janë zbatuar në praktikë.

Në shkurt të vitit 2022 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, sipas të cilit ligj është themeluar Gjykata Komerciale. Pak ditë para hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli Gjyqësor i Kosovës i ka shprehur ankesat e tij për mungesë të mbështetjes buxhetore për themelimin e kësaj Gjykate, siç ishte përcaktuar në atë ligj. “Me buxhetin e vitit 2022 dhe

<sup>36</sup> Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 96.

<sup>37</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2023, shih linkun: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3\\_en?filename=SWD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf), (i qasshëm së fundi më 16 shtator, 2024).

<sup>38</sup> Instituti i Kosovës për Drejtësi, Analysis of the satisfaction results of Court users and lawyers in the Basic Court in Pristina, in the Basic Court in Mitrovica and in the Basic Court in Peja, as a tool for court management, based on the methodology of the European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), see link: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/23353\\_KGJK\\_Alaniza\\_CEPEJ.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/23353_KGJK_Alaniza_CEPEJ.pdf)

pozitat e lejuara Këshilli qysh sot e bën të njohur që Gjykata Komerciale nuk ka mundësi me u funksionalizu. Me këtë buxhet nuk janë përmbushë as parashikimet që i ka bo vetë Ministria e Drejtësisë, sepse me parashikimin Ministrisë së Drejtësisë, do duhej minimumi të ishin 94 pozita të lejume, ndërsa janë 44 pozita të lejume', u shpreh Zogaj në mbledhjen e KGjK-së.<sup>39</sup> Kjo mospërputhje midis ndarjeve buxhetore dhe kërkesave të përcaktuara në ligj ka shkaktuar sfidë të madhe. Prandaj, kjo e vë në pah nevojën për mbështetje dhe resurse financiare adekuatë për t'i zbatuar reformat ligjore në mënyrë efektive dhe për ta siguruar funksionimin e duhur të institucioneve gjyqësore.

Neni 57.1 i Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale përcakton se i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në rastet e mbrojtjes së detyrueshme, duke përfshirë rastet kur ndaj tyre është ngritur aktakuzë për ndonjë vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim. Mirëpo, në shkurt të vitit 2023 është miratuar Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, duke e ulur kriterin e mbrojtjes së detyrueshme në vepra e dënueshme me të paktën pesë vjet burgim (neni 56.1.1.3). Ky ndryshim e ka rritur automatikisht numrin e veprave penale për të cilat mbrojtja është e detyrueshme në 176. Rrjedhimisht, zbatimi i kësaj dispozite pritet të rezultojë në një barrë buxhetore dukshëm më të lartë. Për ta përmbushur obligimin e ri sipas Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, Këshilli Gjyqësor i Kosovës i ka kërkuar 400 mijë euro shtesë për mbulimin e shpenzimeve të shtuara për avokatët mbrojtës me mjete publike. Megjithatë, kjo kërkesë nuk është marrë parasysh në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024.

Për ta avancuar qasjen në drejtësi, është thelbësore që të miratohen ligje që ofrojnë zgjidhje efektive për situata të ndryshme, veçanërisht në ruajtjen e shtetit të së drejtës. Miratimit të këtyre ligjeve duhet t'i paraprijë një analizë e thellë e problemeve, e cila duhet të bëhet me anë të një procesi të konsultimit të gjerë me të gjithë aktorët relevantë. Megjithatë, në asnjë rast, miratimi i ligjeve nuk duhet të jetë mënyra e vetme e trajtimit të problemeve që kanë të bëjnë me qasjen e qytetarëve në drejtësi. Nëse miratimi i ligjeve nuk shoqërohet me mbështetje financiare për institucionet e mandatuara për zbatimin e tyre, kjo rezulton në norma ligjore që e avancojnë qasjen në drejtësi vetëm në letër, me pak ose aspak ndryshime në praktikë. Prandaj, është esenciale që të bëhet një vlerësim i thukët i buxhetit për secilin ligj, duke e vlerësuar si koston, ashtu edhe dobitë e tij. Përveç kësaj, miratimi i çdo ligji duhet të shoqërohet me një buxhet adekuat për ta mundësuar zbatimin efektiv të tij.

## 6. Analiza kosto-përfitim

Shërbimet e ndihmës juridike vijnë me një gamë të gjerë të kostove e avantazheve. Disa nga këto janë kosto dhe përfitime direkte që vijnë nga ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike. Të tjerat janë pasoja indirekte të shërbimeve të tilla për individin, sistemin e drejtësisë,

---

<sup>39</sup> Kryesuesi i KGjK-së thotë se Gjykata Komerciale nuk mund të funksionalizohet për shkak të mungesës së buxhetit, Betimi për Drejtësi, 21 janar 2022, shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryesuesi-i-kgjk-se-thote-se-gjykata-komerciale-nuk-mund-te-funksionalizohet-per-shkak-te-mungeses-se-buxhetit/> (hapur së fundi më 18 shkurt 2024).



ekonominë dhe shoqërinë.<sup>40</sup> Prandaj, për vlerësimin e efijencës ekonomike të politikave publike përdoret analiza kosto-përfitim, e cila e arrin këtë nëpërmjet matjes sistematike të kostove dhe dobive shoqërore.<sup>41</sup>

Varësisht nga koha e analizës, Analiza Kosto-Përfitim (AKP) mund të bëhet si *ex-post*, ashtu edhe *ex-ante*. AKP-ja *ex-post* bëhet zakonisht pas zbatimit të një politikë, për ta vlerësuar performancën, efektivitetin e saj dhe për të parë nëse ajo duhet të zgjerohet apo ndryshohet gjatë proceseve të vendimmarrjes. Edhe anasjelltas, AKP-ja *ex-ante* bëhet përpara hartimit të një politike të ndihmës juridike, për t'i përcaktuar mënyrat më efektive për ndarje të fondeve dhe resurseve.<sup>42</sup>

Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, qëllimi kryesor i bërjes së një AKP-je është që të përcaktohet sasia e përfitimit neto (përfitimet minus kostot) të një politike në një mënyrë të standardizuar dhe të krahasueshme. Kjo përfshin tre komponentë kryesorë për një vlerësim gjithëpërfshirës.

Blloku analitik i parë, apo hapi fillestar, është që të vlerësohet se çfarë do të pritej nga një situatë në të cilën nuk do të bëhej asgjë (përkatësisht nuk do të ekzistonte asnjë projekt). Hapi i dytë përfshin krijimin e një situatë „me projekt”, duke i llogaritur përfitimet dhe kostot e ndjekjes së kësaj alternative. Më në fund, një krahasim i këtyre dy situatave rezulton në përfitimet neto që priten të ndodhin në faza të ndryshme të zbatimit të politikës së ndihmës juridike. Efektiviteti i ndarjes së resurseve për programin e propozuar të ndihmës juridike do të vlerësohet duke i përdorur këto përfitime si bazë për llogaritjen e një varg indikatorësh të performancës financiare dhe ekonomike.<sup>43</sup>

Në këtë aspekt, në disa studime janë analizuar kostot dhe përfitimet që i atribuohen zgjidhjes alternative të kontesteve juridike, këshillave dhe përfaqësimit ligjor në gjykata, me qëllim të zgjerimit të qasjes së hershme në mekanizmat e zgjidhjes së kontesteve për grupet e varfra dhe të marginalizuara<sup>44</sup>, duke përfshirë shmangien e paraburgimit dhe shpenzimeve të dënimit.<sup>45</sup>

Duke e marrë parasysh këtë, vendimmarrësit duhet ta përdorin analizën kosto-përfitim në çdo rast, për t'i vlerësuar efektet financiare të ndihmës juridike dhe shërbimeve që ndërlihen

---

<sup>40</sup> NJË MJET PËR DREJTËSI: ANALIZA KOSTO-PËRFITIM E NDIHMËS JURIDIKE, Banka Botërore, fq.12, shih linkun në: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/592901569218028553/pdf/A-Tool-for-Justice-The-Cost-Benefit-Analysis-of-Legal-Aid.pdf>.

<sup>41</sup> Enciklopedia Ndërkombëtare e Shkencave Sociale dhe të Sjelljes, 2001, <https://www.sciencedirect.com/topics/social-sciences/cost-benefit-analysis>.

<sup>42</sup> NJË MJET PËR DREJTËSI: ANALIZA KOSTO-PËRFITIM E NDIHMËS JURIDIKE, Banka Botërore, fq.12, shih linkun në: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/592901569218028553/pdf/A-Tool-for-Justice-The-Cost-Benefit-Analysis-of-Legal-Aid.pdf>.

<sup>43</sup> Po aty, fq. 26.

<sup>44</sup> Shih Rrjeti i ofruesve të shërbimeve të ndihmës ligjore, analiza e koston-përfitimit të politikës kombëtare të ndihmës juridike të Ugandës, maj 2016, <http://www.laspnet.org/joomla-pages/reports/researchreports/405-cost-benefit-analysis-of-the-uganda-national-legal-aid-policy/file>.

<sup>45</sup> NJË MJET PËR DREJTËSI: ANALIZA KOSTO-PËRFITIM E NDIHMËS JURIDIKE, Banka Botërore, fq.18, shih linkun në: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/592901569218028553/pdf/A-Tool-for-Justice-The-Cost-Benefit-Analysis-of-Legal-Aid.pdf>.

me to, për të vendosur për mënyrën më të mirë për ta trajtuar hendekun e drejtësisë dhe për t'i ndarë fondet në mënyrë më efektive.

## 7. Përfundime

Qëllimi i këtij dokumenti të politikës është që ta ilustrojë rëndësinë e krijimit të një sistemi të drejtësisë të fortë, me qytetarin në qendër dhe me financim adekuat nga qeveria. Një sistem i drejtësisë që bazohet fort në nevojat dhe realitetet e qytetarëve të tij jo vetëm që e nxit një ndjenjë të sigurisë dhe besimit në mesin e popullatës, por luan rol të madh edhe në mbështetjen e sundimit të ligjit. Financimi adekuat është faktor i domosdoshëm për ta siguruar efektivitetin e një sistemi të tillë.

Qasja në drejtësi për të gjithë qytetarët, pavarësisht gjendjes socio-ekonomike, është thelbësore. Kështu, përmes financimit, individëve me të ardhura të ulëta, komuniteteve të marginalizuara dhe viktimave të diskriminimit u mundësohet që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kërkojnë drejtësi. Në këtë aspekt, duhet të krijohen sisteme të përshtatshme për të garantuar që qytetarët që hasin në probleme ligjore të kenë qasje të lehtë në shërbimet themelore dhe të vijës së parë. Kosova duhet të krijojë shërbime të drejtësisë me kosto efektive, siç është ndërmjetësimi, meqë ato janë të dobishme si për palët në procedurë, ashtu edhe për sistemin gjyqësor.

Në anën tjetër, kur të njëjtët individë u drejtohen gjykatave, atyre duhet t'u ofrohet drejtësi menjëherë. Në shumë raste – siç është ilustruar më në hollësi në këtë studim – kufizimet financiare e kanë pamundësuar zbatimin e këtyre alternativave. Krahasuar me sektorët e tjerë, si është ai i kujdesit shëndetësor primar apo ai i arsimit fillor, drejtësia nuk është prioritet në buxhetin e shtetit, përkundër faktit se gjykatat janë adresa përfundimtare ku qytetarët kërkojnë zgjidhje për kontestet e tyre. Për më tepër, në krahasim me rritjet buxhetore që janë bërë ndër vite, nuk ka pasur përparim të dukshëm në këtë fushë. Rritja e përgjithshme e shpenzimeve të qeverisë sipas ligjeve për ndarjet buxhetore nuk është pasqyruar proporcionalisht as në sistemin gjyqësor. Në vitin 2021 dhe 2022, pjesëmarrja e buxhetit të sistemit të drejtësisë në gjithsej shumën e shpenzimeve të qeverisë ka qenë 1,2%. Në anën tjetër, kjo përqindje ka rënë në 1.1% në vitin 2023 dhe 2024. Para së gjithash, të dhënat që janë prezantuar janë shqetësuese, meqë shumë qytetarë nuk kanë kurrfarë informatash se ku mund të kërkojnë ndihmë për problemet ligjore të tyre. Megjithatë, në rastet kur kjo ndihmë kërkohet nga gjykatat, problemi më i theksuar në kuadër të drejtësisë civile në Kosovë është kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve civile. Në anën tjetër, mangësitë financiare shkaktojnë paaftësi të sistemit gjyqësor edhe në forma të tjera. Paaftësia mund të shfaqet në formën e një numri të vogël të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, me mungesë të përkthimit dhe me mosthemelim të degëve të reja të gjykatave.

Për shkak të këtyre sfidave dhe kompleksiteteve, është e domosdoshme që qeveria të sigurojë financim adekuat. Këtij financimi duhet t'i paraprijnë analizat e thukëta në të cilat vlerësohen nevojat dhe efektiviteti, duke siguruar që kostot të jenë maksimalisht të dobishme për qytetarët. Në situatën e Kosovës, me një buxhet të kufizuar, bërja e një analize kosto-përfitim *ex-ante* – pra para se të hartohet një politikë për ndihmën juridike – do të ndihmojë në

përcaktimin e mënyrave më efektive për financim, duke u mbrojtur kështu nga shpenzimet e panevojshme. Prandaj, harmonizimi i sistemit të drejtësisë së Kosovës me aspiratat e bashkësisë ndërkombëtare, sipas OZhQ 16.3, bëhet objektiv i arsyeshëm.

## 8. Rekomandimet

- Të krijohet një mjet për të ndërmarrë analiza të mëtejshme të kostos së vënies së drejtësisë themelore universale. Nevojitet një analizë më e plotë e kostove të drejtësisë themelore universale, por për këtë lipset investim shumë më thelbësor sesa ky hulumtim fillestar.
- Të gjithë aktorët relevantë të sundimit të ligjit duhet të angazhohen në aktivitete të përbashkëta që për qëllim kanë ngritjen e vetëdijes për dobitë e zgjidhjes së kontesteve nëpërmjet procedurës së ndërmjetësimit.
- Sa herë që miratohet një politikë e caktuar, institucionet duhet të analizojnë nëse ajo politikë është në përputhje me parimet e drejtësisë me qytetarin në qendër.
- Sa herë që miratohet një politikë e caktuar, institucionet duhet ta analizojnë koston dhe përfitimet e zbatimit të ndonjë analize të veçantë.
- Në secilin rast, pas miratimit të ligjeve të caktuara, duhet të ndahen mjetet buxhetore përkatëse për zbatimin e atij ligji.
- Nevojat e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas duhet të plotësohen nëpërmjet ligjeve për ndarjet buxhetore, në mënyrë që kjo Agjenci të ofrojë ndihmë juridike falas në të gjitha viset e Republikës së Kosovës.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet ta vlerësojë koston e përgjithshme lidhur me shumën e mjeteve të nevojshme për themelimin e degëve të reja të gjykatave, të cilat sipas ligjit janë të detyrueshme për t'u themeluar.
- Kuvendi duhet ta ndajë një buxhet të mjaftueshëm për rritjen e numrit të gjyqtarëve, në mënyrë që qytetarëve t'u jepet mundësia që drejtësi për ta të ofrohet brenda një kohe të arsyeshme.
- Kuvendi duhet të ndajë buxhet të mjaftueshëm për rekrutimin e bashkëpunëtorëve profesionalë, siç kërkohet me Ligjin Nr. 06/L-054 për Gjykatat, për ta rritur efikasitetin e gjykatave në ofrimin e drejtësisë për qytetarët.
- Kuvendi duhet të ndajë buxhet të mjaftueshëm për rekrutimin e përkthyesve, në mënyrë që secilit qytetar t'i garantohet e drejta për ta përdorur gjuhën që e kupton.